VENDIM
Nr.351, datë 12.5.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE, NË "FILOZOFI SOCIALE", NË FAKULTETIN E MËSUESISË TË UNIVERSITETIT "FAN S.NOLI", KORÇË, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26,34,42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në fakultetin e mësuesisë të universitetit "Fan.S.Noli", Korçë, të programit të studimeve të ciklit të dytë, në "Filozofi sociale".
2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet "Diplomë e Nivelit të Dytë, DND, në filozofi sociale".
3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.
4. Programi i studimeve të ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike.
5. Kuota e pranimit në këtë program studimesh, për vitin akademik 2010-2011, është 20.
6. Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, për këtë program studimesh, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.
7. Universiteti "Fan S.Noli", Korçë duhet të përcaktojë kriteret e pranimit të kandidatëve dhe t'i bëjë ato publike paraprakisht.
8. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
9. Tarifa e shkollimit për këtë program studimesh të ciklit të dytë, për vitin akademik 2010-2011, është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.
10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit "Fan S.Noli", Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.
11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Fan.S.Noli", Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha